

VENDIM
Nr. 947, datë 29.12.2014

PËR AUTORIZIMIN E ALBPETROL SHA PËR TË MARRË, NË PARA, VLERËN KORRESPONDUESE TË SASISË SË PRODHIMIT TË GJYKUAR DHE TË PJESËS SË ALBPETROL SHA, QË I TAKON NË BAZË TË ZBATIMIT TË MARRËVESHJEVE HIDROKARBURE, TË LIDHURA ME KONTRAKTORËT, PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NGA VENDBURIMET EKZISTUESE TË NAFTËS E TË GAZIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 9, 12 e 13, të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të autorizojë Albpetrol sh.a. që të marrë, në para, vlerën korresponduese të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol, sh.a., që i takon në bazë të marrëveshjeve hidrokarbure, të lidhura me kontraktorët, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës e të gazit.

2. Për zbatimin e pikës 1, të këtij vendimi, Albpetrol sh.a. duhet të hyjë në negociata me shoqëritë, me të cilat ka lidhur marrëveshje hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës dhe të gazit, në mënyrë që të marrë, në para, vlerën korresponduese të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol sh.a., që i takon në bazë të këtyre marrëveshjeve hidrokarbure.

3. Çmimi referues, për të realizuar konvertimin në para të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol sh.a., do të përllogaritet mbi bazën e çmimit mesatar të ponderuar të naftës bruto, të shitur nga Kontraktori, gjatë muajit kalendarik përkatës, i cili i korrespondon muajit, në të cilin Kontraktori duhet të përmbushë detyrimin ndaj Albpetrol sh.a. për shlyerjen, në para, të Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol sh.a. dhe në varësi të vendit të lëvrimit të sasisë së naftës që shitet nga Kontraktori, si më poshtë vijon:

a) Në rastin kur shitja e sasisë së naftës bruto realizohet në pikën e lëvrimit në zonën e kontratës, çmimi referues do të jetë i njëjtë me çmimin e shitjes së naftës bruto;

b) Në rastin kur shitja e sasisë së naftës bruto realizohet brenda vendit dhe në një pikë tjetër, të ndryshme nga pika e lëvrimit në zonën e marrëveshjes hidrokarbure, çmimit referues i zbriten kostot e transportit nga pika e lëvrimit te pika respektive shitjes;

c) Në rastin kur sasia e naftës bruto shitet në eksport (shitje FOB), çmimi referues do të llogaritet mbi bazën e çmimit të shitjes, të cilit duhet t'i zbritet kostoja e transportit nga pika e lëvrimit brenda zonës së marrëveshjes hidrokarbure deri në pikën e eksportit (FOB), tarifa e depozitimit, duke përfshirë edhe kostot e mundshme të sigurimit.

Vlerës korresponduese, në para, të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol sh.a., që Kontraktori i detyrohet Albpetrol sh.a., do t'i zbritet vlera e rentës minerare korresponduese për sasinë përkatëse të naftës bruto, e paguar nga ana e Kontraktorit.

Rregullat e hollësishme dhe procedurat e marrjes, në para, të vlerës korresponduese të sasisë së Prodhimit të Gjykuar dhe të Pjesës së Albpetrol sh.a. përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për hidrokarburet dhe ministrit përgjegjës për financat.

4. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama